

**BASHKIA LEZHE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.  
07.01.2019

Lezhë, më

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Data 07.01.2019

Për: Euro Alb sh.p.k , me nr Nipti: K66613407H

Procedura e prokurimit: Kerkese per propozim me mjete elektronike

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-91012-10-23-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: : Blerje vegla pune dhe atrecatura per punonjesit e Drejtorise se Sherbimeve Publike

.Afati i dorezimit te mallrave : 15 dite nga dt. e nenskrimit te kontrates



Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1-Euro Alb sh.p.k , me nr Nipti: K66613407H,dhe me vlere oferte 1 217 910 ( njemilion e dyqind e shtatembedhjete mije e neneteqind e dhjete ) leke pa t.v.sh

2-Denisa Beshaj me nr Nipti: L41904011K me vlere oferte 1 220 500 (njemilion e dyqind e njezet mije e peseqind ) leke pa t.v.sh

3- Ekspo Sistem sh.p.k.me nr Nipti: K01621001F, me vlere oferte :Ska.

4- Stella sh.p.k me nr Nipti: J87603505T dhe me vlere oferte 1 475 600 (njemilion e katerqind e shtatedhjete e pese mije e gjashteqind ) leke pa t.v.sh

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

**1.OE Stella sh.p.k me nr Nipti: J87603505T dhe me vlere oferte 1 475 600 (njemilion e katerqind e shtatedhjete e pese mije e gjashteqind ) leke pa t.v.sh nuk permbush kriteret e**

vecanta te kualifikimit te kerkuar ne DST konkretisht:

Se pari: Nga dokumentacioni i paraqitur ne permbushje te kriterëve te vecanta te kualifikimit ne lidhje me furnizime te ngjashem, te kerkuara ne piken 2.3.1 te DST , OE Stella sh.p.k ka paraqitur vetem fatura tatimore blerje per veglat dhe paisjet e sigurise dhe jo fatura tatimore shitjeje qe te provoje furnizimet e ngjashme. Gjithashtu vertetimet nr 2324 date 01.04.2016 dhe nr 2638 date 18.6.2015, nuk jane shoqeruar me kontratat respektive te furnizimit .

Se dyti : Ne permbushjet te pikes 1 germa b te kriterëve te vecanta te kualifikimit . *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.* OE nuk ka vertetuar shlyerjen e detyrimit te maturuar te energjise elektrike per muajin Gusht 2018.

Se treti: OE Stella sh.p.k nuk ka paraqitur deklaraten e garancise se produkteve , e kerkuar kjo ne piken 2.3.5 *Deklarate qe produktet te kene garanci 12 muaj nga data e dorezimit*, te kriterëve te vecanta te kualifikimit.

Se katerti : OE Stella sh.p.k nuk ka paraqitur deklaraten e konformitetit produkteve , me standartet CE e kerkuar kjo ne piken 2.3.7 *Operatori ekonomik duhet te deklarroje qe te gjitha mallrat e ofruara jane produkte konforme standarteve CE* , e kriterëve te vecanta te kualifikimit.

Komisioni i vleresimit te ofertave mbeshtetur në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;” si dhe ne në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...” vendosi te refuzoje oferten e Stella Sh.p.kper mospermbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese

2- Ekspo Sistem sh.p.k.me nr Nipti: K01621001F, me vlere oferte :Ska. Nuk ka paraqitur asnje dokument ne permbushje te kriterëve te pergjithshme apo te vecanta te kualifikimit dhe as nuk ka paraqitur oferte ekonomike, Komisioni i vleresimit te ofertave vendos skualifikimin e OE Ekspo Sistem sh.p.k

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Euro Alb sh.p.k , me nr Nipti: K66613407H, 1 217 910 ( njemilion e dyqind e shtatembedhete mije e neneteqind e dhjete )

leke pa t.v.sh se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme 1 217 910 ( njëmilion e dyqind e shtatembdhjete mijë e neneteqind e dhjete ) leke pa t.v.sh leke është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[bashkise Lezhe , sektorit te prokurimeve publike ]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej /1 220 500 (njemilion e dyqind e njezet mijë e peseqind ) leke pa t.v.sh ], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : 27.12.2018

Ankesa: ka ose jo: PO Ka paraqitur ankesë operatori ekonomik Euro-Alb shpk me date 15.11.2018.

Me vendimin e Komisionit te Prokurimit Publik nr.852/2018date 19.12.2018 eshte shfuqizuar vendimi i KVO mbi skualifikimin e subjektit Euro-Alb shpk dhe eshte vendosuar kualifikimi i ketij subjekti .



**KRYETARI**  
**FRAN FRROKAJ**

